# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6956
E shtunë, 29 korrik 2023
Çmimi 0.40


## Ushtria jordaneze trajnohet për kërkim-shpëtim urban në qendrën e FSK-së FAQE 3




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË (MINT) E KA HEDHUR POSHTË ANKESËN E KLAN KOSOVËS PËR SHFUQIZIMIN E PEZULLIMIT TË CERTIFIKATËS SË BIZNESIT

# MARRËZIA E RADHËS E QEVERISË KURTI KUNDËR KLAN KOSOVËS FAQE 4-5




Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë ka refuzuar ankesën e televizionit Klan Kosova ndaj pezullimit të certifikatës së biznesit. Në një njoftim të kësaj ministrie thuhet se ankesa është refuzuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe tashmë çështja është përmbyllur si rast brenda ministrisë, ndërsa "pala ankuese gëzon të drejtën për të parashtruar padi në gjykatën kompetente". Ndaj tendencës së qeverisë për të rrezikuar një ndër mediumet më të mëdha në vend, Klan Kosova, kanë reaguar organizatat dhe institucionet kryesore të medias dhe fjalës së lirë në vend dhe në botë, qeveritë e shteteve të Quintit dhe liderë të të drejtave të njeriut gjithandej, duke e cilësuar këtë si sulm i drejtpërdrejtë ndaj demokracisë në Kosovë

## GATI 200 MILIONË NJERËZ NË SHBA PO PËRBALLEN ME NXEHTËSI EKSTREME OSE PËRMBYTJE FAQE 2



## ODA AMERIKANE I KËRKON QEVERISË T'I ADRESOJË MENJËHERË SFIDAT E RRITJES EKONOMIKE FAQE 7



## AKTUALE



### BIDENI TAKON MELONIN: TË PËRKUSHTUAR PËR STABILITET DHE SHTENSIONIM NË BALLKANIN PERËNDIMOR F. 2

### KOMUNA E GJAKOVËS MERR NËN PËRKUJDESJE GURIN E NËNËS PASHKË, E DËRGON NË MEJË F. 3

### KRYETARI I PRIZRENIT I OFRON PËRKRAHJE UNIVERSITETIT "UKSHIN HOTI" F. 6

## EKONOMI



### QEVERIA PUBLIKON MASAT E REJA MBROJTËSE PËR PRODUKTET E NAFTËS F. 7

### MIRATOHET LIGJI PËR TATIM NË PRONË, QYTETARËVE U ZBRITEN DERI 100 EURO NGA FATURAT F. 7

## SPORT



### MINISTRI ÇEKU: KOSOVA KANDIDATE SERIOZE PËR ORGANIZIMIN E LOJËRAVE MESDHETARE 2030 F. 10


RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051 044/367-061 028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

# Gati 200 milionë njerëz në ShBA po përballen me nxehtësi ekstreme ose përmbytje

UASHINGTON, 28 KORRIK - Gati 200 milionë njerëz në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ose rreth 60 për qind e gjithsej popullsisë së ShBA-së, janë nën paralajmërim për të nxehtit ose për përmbytje, teksa temperaturat e larta po përhapen dhe stuhi të reja priten në zona të reja.

Shërbimi Kombëtar i Motit tha se një valë "e rrezikshme" e të nxehtit e kaploi verilindjen dhe qendrën e Atlantikut më 27 korrik dhe do të vazhdojë deri në fundjavë. Stuhi të forta dhe përmbytje të shpejta parashikohet se mund t'i godasin zonat në verilindje dhe jug.

Shkencëtarët kanë paralajmëruar prej kohësh se ndryshimi i klimës, i nxitur nga djegia e lëndëve djegëse fosile, do të çojë në periudha të zgjatura dhe më të shpeshta të motit ekstrem.

Parashikimi për vapën e vazhdueshme vjen një ditë pasi Organizata Botërore Meteorologjike dhe Shërbimi i Ndryshimeve Klimatike të Bashkimit Evropian Copernicus shpallën korrikun e vitit 2023 muajin më të nxehtë të regjistruar ndonjëherë.

Të enjten nxehtësia dhe lagështia në qytetet e mëdha përgjatë Bregut Lindor, përfshirë Uashingtonin, Filadelfian dhe Nju-Jorkun, bënë që temperaturat të ishin ndjeshëm mbi 38 gradë celsius.

Për shkak të nxehtësisë ekstreme, dy nga rrjetet më të mëdha të energjisë në vend janë nën stres, gjë që mund t'ua limitojë amerikanëve mundësinë për t'u freskuar.

Rrjeti më i madh energjetik i vendit, PJM Interconnection, shpalli alarmin e emergjencës energjetike të nivelit të parë për rrjetin e tij në 13 shtete më 26 korrik, që do të thotë se kompania është e shqetësuar për aftësinë e saj për të siguruar energji elektrike të mjaftueshme.



"PJM-ja aktualisht ka gjenerim të mjaftueshëm për ta përmbushur kërkesën e parashikuar, por operatorët vazhdojnë t'i monitorojnë kushtet e rrjetit për çdo ndryshim", tha Jeffrey Shields, një zëdhënës i kompanisë.

PJM-ja nuk është i vetmi rrjet elektrik që ka lëshuar një alarm të tillë. Operatori i Pavarur i Sistemit Midcontinent, i cili mbulon kryesisht shtetet në Rrafshnaltën e Mesme dhe Veriore, lëshoi një alarm të ngjashëm më 27 korrik.

Operatori i Pavarur i Sistemit të Kalifornisë lëshoi gjithashtu një alarm emergjence energjie për mbrëmjen e 26 korrikut, pjesërisht për shkak të nxehtësisë së tepërt në Kaliforninë Jugore, por alarmi u shua në po të njëjtën ditë.

Një zëdhënës i Këshillit të Besueshmërisë Elektrike të Teksasit tha se ata presin që rrjeti i tyre të funksionojë si zakonisht përkundër valës së fundit të motit ekstrem në të gjithë vendin.

# Roja presidenciale e Nigerit e shpall veten udhëheqës të shtetit pas puçit

ABUJA, 28 KORRIK - Shefi i gardës presidenciale në Niger, gjenerali Omar Tchiani, e ka emëruar veten president të Këshillit Kombëtar dhe lider të ri të vendit afrikan.

Tchiani i bëri këto deklarata në televizionin kombëtar të premten më 28 korrik.

Oficerët e rojës presidenciale e arrestuan presidentin e Nigerit, Mohamed Bazoum, i cili ishte zgjedhur në mënyrën demokratike më 2021 - në pallatin e tij presidencial të mërkurën.

Në mbrëmjen e njëjtë, 10 oficerë ushtarakë njoftuan në televizionin kombëtar se Këshilli Kombëtar për Sigurinë e Atdheut



(KKSA) e ka marrë pushtetin në dorë.

Ministria e Mbrojtjes e Nigerit, vendit të Afrikës Perëndime me një popullsi prej 26 milionë banorë, i ndaloi protestat dhe demonstratat të enjten.

"Forcat tona të mbrojtjes dhe sigurisë... kanë vendosur t'i japin fund regjimit të cilin e njihni edhe ju", tha koloneli Amadou Abdramane gjatë një fjalimi në televizion kombëtar.

Ushtria e Nigerit i ka paralajmëruar shtetet e huaja të mos tentojnë ndërhyrjen ushtarake, duke thënë se ajo mund të ketë pasoja shkatërruese për vendin.

Pui është duke u mbështetur edhe nga partitë opozitare, sipas një deklarate të publikuar në mediet e Nigerit. Mbetet e paqartë se për sa parti opozitare bëhet fjalë.

Të enjten përpjekjet e ushtrisë për ta marrë në dorë pushtetin e vendit u kritikuan ashpër nga Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, Unioni Afrikan dhe qeveritë individuale, përfshirë ajo e Rusisë dhe ajo e Gjermanisë.

Berlini i ka rreth 100 ushtarë të vendosur në Niger.

Koloneli i Ushtrisë së Nigerit, Amadou Abdramane, tha të mërkurën vonë në televizionin kombëtar se ushtria i ka pezulluar të gjitha institucionet dhe i ka mbyllur të gjithë kufijtë në vendin e Afrikës Perëndimore.

Të enjten u mbyll edhe hapësira ajrore e Nigerit.

Sekretari i Shtetit i ShBA-së, Antony Blinken, ka bërë thirrje për lirimin e "menjëhershëm" të Bazoumit si dhe për "për respektimin e menjëhershëm të sundimit të ligjit dhe për siguri publike".

## Bideni takon Melonin: Të përkushtuar për stabilitet dhe shtensionim në Ballkanin Perëndimor

UASHINGTON, 28 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, dhe kryeministrja e Italisë, Giorgia Meloni, diskutuan, ndër të tjera, për situatën në Ballkanin Perëndimor gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë më 27 korrik.

Sipas deklaratës së përbashkët të liderëve të ShBA-së dhe Italisë, të lëshuar nga Shtëpia e Bardhë, ndër pikat e diskutimit në takimin e tyre ishte sigurimi i stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, rajon ku bëjnë pjesë Kosova, Serbia, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Bosnjë-Hercegovina.

"Shtetet e Bashkuara dhe Italia riafirmojnë angazhimin e tyre të përbashkët për sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e Ballkanit Perëndimor dhe mbështetjen e tyre të kamotshme për integrimin euroatlantik të rajonit", thuhet në deklaratën e publikuar.

Në deklaratën e publikuar nga Shtëpia e Bardhë thuhet se ShBA-ja e "mirëpret angazhimin e qeverisë italiane në Ballkanin Perëndimor, duke përfshirë kontributin e forcave të armatosura italiane në misionet e KFOR-it, EULEX-it dhe EUFOR-it".



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

## Komuna e Gjakovës merr nën përkujdesje gurin e nënës Pashkë, e dërgon në Mejë



GJAKOVË, 28 KORRIK - Komuna e Gjakovës ka njoftuar të premten se e ka marrë nën përkujdesje gurin që simbolizon sakrificën e nënës Pashkë Marku, duke e vendosur atë në afërsi të Kompleksit Memorial në Mejë. Sipas njoftimit për medie, ky gur përkujtimor është vendosur në një ambient publik në atë lokacion vetëm përkohësisht. "Ky veprim është ndërmarrë në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe në marrëveshje me familjen Marku", thuhet në komunikatën për medie.
Guri thuhet se do të qëndrojë në këtë lokacion deri në gjetjen e përbashkët të një zgjidhje të përhershme.
Guri përkujtimor i Pashkë Markut - nënës që dogji veten pas kthimit dhe varrimit të mbetjeve të djemve të saj të vrarë e të djegur nga kriminelët serbë - është hedhur në mbeturina të premten në mëngjes pavarësisht prej reagimeve të shumta në publik kur guri u hoq nga vendi i tij javën e shkuar. Guri është hedhur në mbeturinat në hyrje të Gjakovës përballë varrezave të qytetit.

# Ushtria jordaneze trajnohet për Kërkim-Shpëtim Urban në qendrën e FSK-së

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 28 KORRIK - Në kuadër të bashkëpunimit me Mbretërinë Hashemite të Jordanisë, një ekip i ushtrisë së Jordanisë ka realizuar trajnimin për Kërkim-Shpëtim Urban në Qendrën Ndërkombëtare të Trajnimit për Kërkim-Shpëtim (QNTKSh), të Gardës Kombëtare të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Pomozotin.
Sipas njoftimit, për tri javë është realizuar trajnimi në pjesën teorike dhe praktike, ku 10 ushtarakë nga Jordania dhe pesë nga FSK-ja janë përgatitur me njohuritë bazë dhe të avancuara në temat: hapja dhe siguria e rrugëve deri te viktimat përmes thyerjeve dhe prerjeve, dhënien e ndihmës së parë mjekësore, evakuimin e viktimave etj.
Realizimi i trajnimeve në QNTKSh është dëshmi e nivelit të lartë të profesionalizmit të trajnerëve të kësaj qendre, po ashtu e bashkëpunimit të shkëlqyer që kemi me partnerët tanë strategjikë për shkëmbimin e përvojave dhe ngritjen e kapaciteteve. Në ceremoninë e certifikimit të pranishëm ishin ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, komandanti i Gardës Kombëtare gjeneralbrigade Naim Haziri, drejtori i QNTKSh-së, John Donne si dhe oficerë të FSK-së e të NALT-it.
Ministri Mehaj dhe gjeneral Haziri vlerësuan lart bashkëpunimin në mes dy ushtrive duke shprehur gatishmërinë për zgjerimin dhe avancimin e këtij bashkëpunimi edhe në fusha të tjera me interes të përbashkët.
Kapiten Ahmad nga ushtria jordaneze falënderoi FSK-në për mundësinë e krijuar për ta realizuar trajnimin e kërkim-shpëtimit dhe përgëzoi QNTKSh-në për aktivitet dhe operacionet e realizuara të kësaj njësie, në veçanti operacionin e realizuar në Republikën e Turqisë pas tërmetit. "Uroj që të certifikuarit t'i vejnë njohuritë e fituara përmes këtij trajnimi kurdo që komuniteti ka nevojë për ndihmën e tyre. Përgëzime për Komandantin e Gardës Kombëtare, trajnerët e FSK-së dhe drejtorin e QNTKSH, John Donne për punën e shkëlqyer që në vazhdimësi është duke u treguar e suksesshme", ka theksuar ministri Mehaj.

# Ngrihet aktakuzë për një serb të dyshuar për krime lufte në Kosovë



PRISHTINË, 28 KORRIK - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë më 28 korrik ndaj Z. A mbi dyshimet për krime lufte ndaj popullatës civile gjatë luftës së fundit në Kosovë.
Z. A., i cili i përket nacionalitet serb, u arrestua fillimisht më 7 mars, ndërsa më 8 mars atij iu vendos masa e paraburgimit prej një muaji nga Gjykata Themelore në Prishtinë.
Në njoftimin e PSRK-së thuhet se Z. A. dyshohet se ai "e kishte ndaluar në qendër të qytetit të kamenicës të dëmtuarin B. M. duke e torturuar në mënyrë çnjerëzore, keqtrajtuar dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore, traumë dhe pasoja në shëndet si dhe duke e kanosur seriozisht për jetë për një orë e gjysmë".
Ai, gjithashtu, akuzohet se kishte marrë pjesë në dëbimin dhe shpërnguljen me dhunë të qytetarëve të Kamenicës. "… Pastaj kanë filluar të bëjnë plaçkitjen e shtëpive, më pas, me qëllim të dëmtimit të pronës së shqiptarëve, ua kanë vënë zjarrin, po ashtu kanë marrë pjesë në keqtrajtimin e civilëve shqiptarë", thuhet në njoftimin e PSRK-së.
Këto veprime Z. A. dyshohet se i kishte kryer gjatë periudhës së luftës në Kosovë "në bashkëkryerje me pjesëtarë të tjerë të policisë serbe" dhe "i uniformuar me uniformë të policisë serbe dhe i armatosur".
Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-99 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur - pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.

## Begaj: ShBA-ja, partnerja strategjike më e madhe e shqiptarëve



TIRANË, 28 KORRIK - Presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, në 101-vjetorin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara, ka shkruar se këto marrëdhënie janë gjithnjë e më të forta. Begaj ka shkruar në "Facebook" se përgjatë historisë Shtetet e Bashkuara kanë qenë gjithmonë në krahun e Shqipërisë. "Gjithmonë duke na mbështetur në të gjitha projektet dhe sukseset tona madhore, ndaj për këtë do t'i jemi përherë mirënjohës. Gëzuar 101-vjetorin e miqësisë me ShBA-në, partnerin strategjik më të madh të Shqipërisë dhe shqiptarëve", ka shkruar ai.




MINISTRIA E INDUSTRISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË (MINT) E KA HEDHUR POSHTË ANKESËN E KLAN KOSOVËS PËR SHFUQIZIMIN E PEZULLIMIT TË CERTIFIKATËS SË BIZNESIT

# Marrëzia e radhës e qeverisë Kurti kundër Klan Kosovës

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë në Kosovë ka refuzuar ankesën e televizionit Klan Kosova ndaj pezullimit të certifikatës së biznesit. Në një njoftim të kësaj ministrie thuhet se ankesa është refuzuar nga Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve dhe tashmë çështja është përmbyllur si rast brenda ministrisë, ndërsa "pala ankuese gëzon të drejtën për të parashtruar padi në gjykatën kompetente". Ndaj tendencës së qeverisë për të rrezikuar një ndër mediumet më të mëdha në vend, Klan Kosova, kanë reaguar organizatat dhe institucionet kryesore të medias dhe fjalës së lirë në vend dhe në botë, qeveritë e shteteve të Quintit dhe liderë të të drejtave të njeriut gjithandej, duke e cilësuar këtë si sulm i drejtpërdrejtë ndaj demokracisë në Kosovë

EPOKA E RE **Mal QORRAJ**

**Prishtinë, 28 korrik** - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) e ka hedhur poshtë ankesën e Klan Kosovës për shfuqizimin e pezullimit të certifikatës së biznesit të televizionit privat më 28 korrik.

Më 14 qershor Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ngriti kallëzimi penal ndaj Shoqërisë Tregtare "Klan Kosova". Kallëzimi penal u ngrit me "pretendimin se në certifikatën e biznesit, te ndërrimi i pronarëve, figuron Pejë - Serbia dhe Gjakovë - Serbia".

Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave për Regjistrimin e Bizneseve vendosi të premten se Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) kishte "vepruar në përputhje me ligjin kur e pezulloi certifikatën e biznesit të Klan Kosovës".

Vendimi i Komisionit e përmbyll këtë rast brenda Ministrisë, ndërsa pala ankuese gëzon të drejtën për të parashtruar padi në gjykatën kompetente, njoftoi MINT të premten.

Klan Kosova ka thënë pas vendimit se "në asnjë rrethanë nuk do ta pranojë një qasje të tillë autoritare" nga institucionet e shtetit dhe se çështjen do ta dërgojë në gjykatë.

Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Jorn Rohde, zgjodhi rrjetin social "Twitter" për të reaguar ndaj vendimit të MINT-it. "Shumë shqetësuese: Mbyllja e njërës prej mediumeve më të mëdha në Kosovë do të ishte një goditje e rëndë për lirinë e medias", ka shkruar ai.

Juristja e së drejtës së medias në Prishtinë, Flutura Kusari, ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje, kryeministri Albin Kurti dhe ministrja Rozeta Hajdari "kanë marrë vendim politik për ta mbyllur Klan Kosovën". Ajo e përshkroi vendimin si "sulmi më i madh" që i është bërë pluralizmit të medias dhe demokracisë në Kosovë nga një parti politike.



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AKG) është shprehur i "alarmuar" me vendimin e Komisionit të Ankesave për ta refuzuar ankesën e televizionit Klan Kosova, duke e cilësuar atë si të "motivuar politikisht" nga qeveria e kryeministrit Albin Kurti. "AGK-ja beson se ky proces që nga fillimi ka qenë i motivuar politikisht nga partia në pushtet dhe qeveria e kryeministrit Kurti në përpjekje për të mbyllur televizionin më të madh privat në vend. Vendimi i sotëm i ministrisë së udhëhequr nga ministrja Hajdari konfirmon luftën e hapur dhe të paprecedent të kësaj qeverie kundër medieve si paralajmërim që edhe të tjera medie do të jenë cak i sulmeve", thuhet në një reagim të asociacionit.

Ndaj këtij vendimi ka reaguar edhe sekretari i përgjithshëm i

# Mavraj: Nga regjistri i marrëzive të kësaj qeverie **pritej edhe marrëzia kundër Klan Kosovës**

Publicisti Muhamet Mavraj ka reaguar ndaj vendimit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) që ka hedhur poshtë ankesën e Klan Kosovës për shfuqizimin e pezullimit të certifikatës së biznesit.

Mavraj ka shkruar në "Facebook" se nga regjistri i marrëzive të kësaj qeverie pritej edhe marrëzia kundër Klan Kosovës. "Prej sot nuk jemi as demokraci liberale as parlamentare. U futëm në demokraturë. Me këso lloje të praktikave qeverisëse nuk ka gjasë për integrimet euroatlantike", ka shkruar ai, duke shprehur solidarizimin me kolegët e Klan Kosovës.

**Reagimi i plotë i Mavrajt:**

*E dini moti, ai stan atë bulmet ka, përgjithmonë. Nga regjistri i marrëzive pritej edhe marrëzia kundër Klan Kosovës.*

*Pak është ta qajmë Klanin sa është për ta vajtuar keqtrajtimin e Kosovës, përpjekjet e vazhdueshme për ta bërë shtet të dështuar.*

*Prej sot nuk jemi as demokraci liberale as parlamentare. U futëm në DEMOKRATURË. Me këso lloje të praktikave qeverisëse nuk ka gjasë për integrimet euroatlantike.*

*Natyrisht, do të kthehemi në rrugën e civilizimit, sado që do të paguajmë faturë të domosdoshme. E pamundshmja nuk ekziston.*

*Solidarizohem me kolegët e Klan Kosovës. Ata vendosin për format e reagimit ndaj errësirës.*




Federatës së Gazetarëve Evropianë (FGE), Ricardo Gutierrez, i cili shkroi në "Twitter" se Kosovën e kanë mbuluar "ditë të zeza të censurës shtetërore", dhe se qeveria më në fund "korri sukses në mbylljen" e Klan Kosovës. "Qeveria e Albin Kurtit po e zhyt vendin në liberalizmin më konservator, duke i përbuzur plotësisht vlerat e BE-së", shkroi Gutierrez.

Në njoftimin e MINT-it të premten pasdite, thuhet: "Vetë fakti që përfaqësuesit e Klan Kosovës sh.p.k., pas kaq shumë vitesh, kanë nisur hapa për korrigjim, vërteton se biznesi në fjalë e kishte kryer shkeljen e konstatuar nga ARBK-ja dhe se vendimi për pezullimin e certifikatës së biznesit ishte marrë me të drejtë".

Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka thënë se vendimi i qeverisë për ta mbyllur Klan Kosovën, duke i marrë certifikatën e biznesit, është i papranueshëm, i rrezikshëm, i paligjshëm dhe kundër secilës vlerë demokratike mbi të cilat është ngritur shteti ynë. "Kjo qeveri e ka humbur rrugën! Nga paniku, çdo ditë e më shumë po zhytet në llumin e vendimeve ta padinjitetshme dhe me tendenca diktatoriale. Prandaj, sot, jemi të gjithë të bashkuar kundër këtij vendimi autoritar dhe në mbrojtje të lirisë së shprehjes dhe medias së lirë. Mos e mbyllni Klan Kosovën. Diktatura nuk kalon!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Edhe kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka reaguar për rastin e Klan Kosovës.

Ai ka thënë se mbyllja e Klan Kosovës është sulm i një pushteti autoritar ndaj fjalës së lirë. "Është sulm i paranojës propagandistike ndaj vetë demokracisë. Ky pushtet do krizë. Ky pushtet do frikë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka thënë se në këtë betejë të paprecedentë nuk është vetëm një televizion. "Janë të gjitha mediet, gazetarët e promovuesit e fjalës së lirë. Jemi të gjithë, individualisht e kolektivisht. Prandaj dhe në këtë përballje do të jemi bashkë të gjithë. Fjala e lirë do të triumfojë. Urdhrat e Polit Byrosë nuk e mundin dot demokracinë kosovare. Shoqëria kosovare ka triumfuar dhe në përballje më të rënda. Do ta kapërcejë dhe këtë", ka theksuar lideri i LDK-së.

Abdixhiku i ka ftuar organet e drejtësisë, gjykatat e Republikës, të bëjnë detyrën e vet. "Të mbrojnë vetë demokracinë. Urdhërdhënësit e Polit Byrosë dhe ekzekutuesit e këtyre urdhrave brenda institucioneve të shtetit do të mbahen përgjegjës para ligjit herët apo vonë. Pushtetet janë të përkohshme, shteti mbetet i përhershëm", ka shkruar ai.

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka reaguar ndaj vendimit të qeverisë për ta mbyllur Klan Kosovën. Ai ka theksuar se nuk mbyllen mediet në një vend evropian. "Nuk mbulohet dielli me shoshë o Albin Kurti. Nuk mbyllen mediat në një vend evropian! Nuk jemi Kore e Veriut! Prandaj hiq dorë nga ky vendim i çmendur e lërë Klan Kosovën ta kryejë punën e vet! Dil kërkoju falje popullit e gazetarëve të Klan Kosovës e ruaje pak fytyrë!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

Ambasadorët e shteteve të Quintit dhe Bashkimit Evropian përmes një deklarate publike kanë reaguar lidhur me vendimin e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë që ta hedhë poshtë ankesën e Klan Kosovës për shfuqizimin e pezullimit të certifikatës së biznesit. Ata janë shprehur me shqetësim për vendimin e ministrisë, duke thënë se ai mund të ketë pasoja për pluralitetin mediatik në Kosovë.

Quinti dhe BE-ja kanë thënë se presin proces të drejtë dhe transparent për ta zgjidhur këtë situatë. "Revokimi i licencës së çdo medie është një hap domethënës që kërkon shqyrtim rigoroz. Liria e shprehjes dhe informimit janë tipare thelbësore të shoqërive demokratike. Presim një proces ligjor të drejtë dhe transparent për zgjidhjen e situatës", thuhet ndër të tjera.

Televizioni kombëtar privat Klan Kosova ka nisur transmetimin më 17 shkurt të vitit 2009. Më 21 qershor, ARBK-ja e kishte shfuqizuar përkohësisht vendimin e 14 qershorit për pezullimin e certifikatës së biznesit të televizionit privat para se ta kthente në fuqi atë menjëherë më 22 qershor. Ky vendim ishte kundërshtuar edhe nga ambasadorët e huaj në Kosovë.

## Njësia e Zjarrfikësve në Mitrovicë pajiset me mjete më të avancuara për raste emergjente

**Mitrovicë, 28 korrik** - Në Njësinë e Zjarrfikësve në Mitrovicë është bërë pranim-dorëzimi i pajisjeve të financuara nga Drejtoria për Siguri dhe Emergjenca. Me këtë rast, nënkryetari i komunës, Arian Tahiri, së bashku me drejtorin për Siguri dhe Emergjenca, z. Bahtir Maxhuni, realizuan një vizitë te shërbimet emergjente - zjarrfikësit. Nënkryetari Tahiri vlerësoi lart punën e zjarrfikësve duke thënë se këto mjete do të jenë një ndihmesë e madhe për zjarrfikësit e Mitrovicës gjatë intervenimeve të tyre. Ndërsa komandanti i Njësisë së Zjarrfikësve në Mitrovicë, Tahir Mikullovci, falënderoi komunën e Mitrovicës për këtë mbështetje, duke shtuar se këto pajisje janë të nevojshme dhe do ta rritin efikasitetin e punës së zjarrfikësve.




# Kryetari i Prizrenit i ofron përkrahje Universitetit "Ukshin Hoti"



**Prizren, 28 korrik** - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të premten për herë të parë rektorin e Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", Mentor Alishani, të shoqëruar me bashkëpunëtorë, për të diskutuar për avancimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimin e mëtejmë në të ardhmen. "Universiteti 'Ukshin Hoti' organizon edicionin e dytë të Shkollës Verore Ndërkombëtare në Prizren, me ç'rast kryetari Totaj rikonfirmoi mbështetjen e Komunës së Prizrenit për realizimin e 'SHVNP 2023'. 200 studentë nga e gjithë bota do të jenë pjesëmarrës në këtë ngjarje që fillon nga 31 korriku, në orën 17:00, deri më 11 Gusht 2023 dhe do të zhvillohet në hapësirat e Universitetit, ITP (Innovationand Training Park) dhe në pjesë të ndryshme të qytetit tonë të bukur", ka njoftuar komuna e Prizrenit.



# Malishevë, afati për paraqitjen e provimit të maturës, nga 14 deri më 17 gusht

**Malishevë, 28 korrik** - Drejtoria për Arsim dhe Edukim në komunën e Malishevës i ka njoftuar të gjithë nxënësit e shkollave të mesme, se afati për paraqitjen e provimit të maturës për afatin e gushtit është nga data 14 deri më 17 gusht. Me këtë rast, DAE i njofton edhe shkollat e mesme se janë të obliguara që deri më 18 gusht t'i dërgojnë shënimet si dhe kërkohet nga shkollat përkatëse që përmes kujdestarëve t'i njoftojnë nxënësit për paraqitjen e provimit të maturës.
Drejtoria për Arsim dhe Edukim, përmes drejtoreshës së drejtorisë, Arbëreshë Krasniqi, u ka uruar suksese të gjithë nxënësve maturantë në provimin e maturës.

# Përfundon asfaltimi i rrugëve në lagjen Istogu në Verboc të Drenasit



**Drenas, 28 korrik** - Në vazhdën e realizimit të projekteve infrastrukturore ka përfunduar me sukses asfaltimi i rrugëve në lagjen Istogu në Verboc të Drenasit. "Angazhimi ynë për zhvillimin dhe rritjen e mirëqenies sociale është dhe do të mbetet i palëkundur për të rritur kështu cilësinë e jetës për të gjithë qytetarët e komunës sonë. Projektet infrastrukturore në komunën e Drenasit po zhvillohen me ritme të shtuara, në mënyrë që sa më parë që është e mundur të jenë të prekshme dhe të shfrytëzueshme për qytetarët tanë", ka njoftuar komuna e Drenasit.

## Kryetari i Podujevës viziton pikën kufitare në Merdar

**Podujevë, 8 korrik** - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka vizituar pikën kufitare në Merdar për t'i përcjellë nga afër hyrje/daljet nga kjo pikë kufitare, ku ka theksuar se me përgjegjësi të lartë dhe efikasitet zyrtarët tanë policorë dhe doganorë ofrojnë shërbime të shpejta për mërgimtarët tanë dhe qytetarët e tjerë. "Gjatë kësaj vizite jam pritur nga komandanti i Pikës Kufitare, kapiteni Ekrem Koliqi, nga i cili jam informuar në detaje për vëllimin e punës që kanë zyrtarët në këtë pikë kufitare dhe me sfidat e përditshme me të cilat ballafaqohen. I përgëzova për punën e jashtëzakonshme që po e bëjnë dhe ju dëshirova punë të mbarë në vazhdimësi!", ka njoftuar Bulliqi.



## Qeveria publikon masat e reja mbrojtëse për produktet e naftës

Prishtinë, 28 korrik - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e Kosovës (MINTK) ka vendosur të premten caktimin e çmimit dhe masave të tjera mbrojtëse të produkteve të naftës. Në bazë të këtij vendimi, marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me shumicë është dy centë për litër, ndërsa marzha tregtare maksimale e lejuar e shitjes me pakicë është 12 centë për litër.

Ky vendim do të jetë në fuqi për 30 ditë.

MINTK tha në një njoftim se ky vendim "është bazuar në monitorimin e rregullt të çmimeve në tregun e produkteve të naftës, evidencën ditore të pranuar nga Dogana e Kosovës, si dhe raportet e përditshme nga Inspektorati i Tregut, lidhur me çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve të naftës, me ç'rast është evidentuar një rritje e çmimeve e cila nuk reflektohet nga lëvizjet e çmimeve në tregun botëror".

Kjo, sipas ministrisë, përbën bazë për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse sipas Ligjit për Tregtinë të Produkteve të Naftës, si dhe udhëzimit administrativ për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe masat e tjera mbrojtëse.

Në tregun e Kosovës një litër naftë kushton mesatarisht 1.39 euro aktualisht.

Çmimet dhe kërkesa për naftë janë rritur në tregjet ndërkombëtare pas pushtimit të Ukrainës nga Rusia në shkurt 2022.



# Oda Amerikane i kërkon qeverisë t'i adresojë menjëherë sfidat e rritjes ekonomike



Prishtinë, 28 korrik - Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë përmes një komunikate drejtuar medieve thotë se njeh potencialin e madh të Kosovës si një destinacion i rëndësishëm për investime. Megjithatë, Oda Ekonomike Amerikane shton se nuk mund të injorohen konkluzionet shqetësuese të nxjerra në Deklaratat e Klimës së Investimeve për Kosovën të publikuara së fundmi nga ana e Departamentit Amerikan të Shtetit. "Këto gjetje, duke theksuar ndërhyrjen thelbësore politike në ekonomi dhe mungesën e dialogut publiko-privat, vënë në spikamë aftësinë e vendit për të tërhequr investimet e huaja direkte (IHD), që janë vendimtare për zhvillimin ekonomik.Është shqetësuese të shihet se çështje të tilla jo vetëm që po ndikojnë në imazhin ndërkombëtar, por gjithashtu po nxisin pakënaqësi në mesin e qytetarëve të Kosovës. Hulumtimi i fundit i Pulsit Publik nga UNDP-ja ka treguar se vetëm 17.7% e qytetarëve janë të kënaqur me drejtimin ekonomik të Kosovës. Kjo statistikë sinjalizon një nevojë urgjente për ndryshim dhe përmirësim sistematik në qeverisjen ekonomike duke nënvizuar peshën e detyrave që duhen zbatuar", thuhet në komunikatë.

Më tutje, në komunikatë thuhet se çështja e rritjes së ndërhyrjeve politike në ekonomi dhe gjyqësor minon drejtpërdrejt besimin e investitorëve, pengon dinamikën e tregut dhe përbën rrezik të konsiderueshëm për investitorët e mundshëm. "Kjo ndërhyrje vë në dyshim reputacionin e Kosovës si një mjedis stabil dhe i parashikueshëm për investime. Pa adresuar këtë, vendi rrezikon të gërryejë më tej besimin e investitorëve dhe qytetarëve të tij.

Në mënyrë të ngjashme, mungesa e një dialogu funksional dhe sistematik publiko-privat, pavarësisht rregulloreve që detyrojnë konsultimin publik, është një çështje shqetësuese. Aprovimi i rregullave të reja shpesh pa diskutime thelbësore me palët e interesit krijon një mjedis rregullator të paparashikueshëm që mund të pengojë investitorët".

Oda Ekonomike Amerikane thekson se, përtej këtyre çështjeve, vendi duhet t'i adresojë edhe sfidat e tjera të rëndësishme, si integrimi i kufizuar ekonomik rajonal dhe global, marrëdhëniet e mira ndërfqinjësore, furnizimi jo i besueshëm me energji dhe vështirësitë në vendosjen e të drejtave pronësore. "Sektori i madh joformal dhe korrupsioni i shfrenuar vazhdojnë të jenë pengues për investitorët, ndërsa të mbështeturit e madh në përkrahjen financiare ndërkombëtare dhe remitencat vë në pikëpyetje qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë së Kosovës.Qeveria duhet të veprojë shpejt dhe me vendosmëri për të zbutur këto shqetësime. Eliminimi i ndërhyrjeve politike, vendosja e një dialogu efektiv publiko-privat dhe zbatimi i strategjive për të luftuar korrupsionin dhe për të përmirësuar infrastrukturën e Kosovës duhet të jenë ndër prioritetet kryesore të agjendës së Qeverisë. Duke nxitur një klimë transparence, parashikueshmërie dhe dialogu të hapur, vendi do të përmirësojë me doemos imazhin e tij para investitorëve të huaj", theksohet në komunikatën e Odës Ekonomike Amerikane.

## Miratohet Ligji për Tatimin në Pronë, qytetarëve u zbriten deri 100 euro nga faturat

Prishtinë, 28 korrik - Kuvendi i Kosovës ka miratuar në lexim të dytë plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Pronën e Paluajtshme. Sipas Ministrisë së Financave, Ligji i ri për Tatimin në Pronën e paluajtshme parasheh mundësinë për të përfituar nga zbritja e faturave të vitit 2023 deri në 100 euro. "Ligji, gjithashtu, parasheh lirime tatimore për banimin primar dhe tokën bujqësore; kufizim të përllogaritjes së interesit që të mos tejkalojë vlerën e detyrimit tatimor; zbritje të shkallës së poshtme tatimore për vitin 2024 dhe fillimin e aplikimit të tatimit progresiv nga viti 2025", thuhet në njoftim.



# Të gjithë me Adem Demaçin, të gjithë kundër Adem Demaçit!



Shkruan: Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA

26 korrik 2018: Nga ora 15.00 deri në ora 16.00, shkuam bashkë me shoqen time Fexhën te Baca Adem që ishte në gjumë dhe dolëm nga dhoma deri në kohën kur u zgjua. Ishte shumë i lodhur. Po atë ditë, para dite e kisha vizituar sikur që e bëja thuaja çdo ditë tjetër prandaj nuk fola dhe biseda ishte midis Fexhës dhe Bacës. Në aspektin e kujdesit ndaj Bacës Adem, Arbërie Demaçi ishte monumentale, e papërsëritshme kurse, kur vinte te unë, e vinte shumë shpesh, Fexha e bënte të pamundurën ta disponojë Bacën bashkë me djemtë tanë; Shkëmbin dhe Blinin të cilët Baca i quante ushtarët e mi kurse këta e quanin Bacën Gjeneral. Baca Adem ia ka lënë emrin Shkëmbit nga kisha katolike në Ferizaj ku ishte në një takim me patriotin e madh, imzot Nikë Prelën. Pasi u përshëndetëm me Bacën dhe pa mbërri ende në shtëpi më telefonoi Arbëria, duke qajtur me fjalët: "na la Baca ..". Ishte ora dikund 16.48 minuta.

Menjëherë u kthyem te shtëpia e Bacës dhe qëndruam aty deri vonë në mbrëmje kur erdhi Prof. dr. Arsim Gërxhaliu me ekipin mjekoligjorë me automorg për ta dërguar në morg shkaku se për shkak të temperaturave të larta duhej të largohej nga shtëpia. U organizuam një grup shokësh që i kishim qëndruar Bacës afër gjatë tërë kohës për të biseduar se ç'duhej bërë që varrimi të jetë ashtu si e ka merituar Baca me jetën dhe veprën e papërsëritshme por, në ndërkohë hyri në lojë Protokolli i Shtetit i cili, së paku ashtu mendonim se do ta kryente punën në mënyrën më të mirë të mundshme. Punët nuk ecën mirë. Kortezhi ishte i paorganizuar, në vendin ku Baca do të prehej në përjetësi ishin individë të cilët, jo se nuk e kanë respektuar Bacën por në mënyrë aktive dhe të ulët kanë punuar në denigrimin e personalitetit të Bacës Adem Demaçi. Kur duhej të organizohej e pamja, kishte propozime që e pamja të bëhej në ndonjë restorant apo lokal të nivelit më të ulët. Jahja Lluka ndërhyri në një çast duke thënë: "çka jeni duke folur ore, po a e dini se kush është Adem Demaçi…". Kishte hezitime nëse do të lejohej e pamja në Teatrin Kombëtar deri në kohën kur Elmi Reçica, për herë të parë e kamë parë me lot në sy tha me një zë të prerë ku nuk linte asnjë mundësi tjetër: "E pamja për Bacën do të bëhet në Teatrin Kombëtar dhe kjo çështje as që diskutohet …".

Ashtu ndodhi. E pamja , po të mos ishin Gëzim Demaçi (nipi i Bacës), Bekim Makolli dhe disa shokë të ngushtë të Bacës, do të dukej krejt ndryshe, e paorganizuar ashtu siç ishte edhe varrimi. LDK –ë 100 % e shpërfilli edhe varrimin e Bacës Adem, nderimet në Kuvendin e Kosovës sikur edhe të pamën. Në të pame ishte vetëm Vlora Dumoshi, jo si anëtare e LDK-së por si vajza e Osman Dumoshit. LDK-ë e vazhdoi propagandën gebelsiane ndaj Bacës Adem Demaçi që e kishte filluar që nga viti 1990 kur u lirua Baca, deri kur kaloi në përjetësi. Edhe tash nuk e harrojnë "zanatin e vjetër " të mësuar në zyrat e Rrahman Morinës dhe patriotëve tjerë jugosllavë dhe serbë! Po të njëjtin linçim publik LDK e bënte ndaj të gjithë ish të burgosurve politikë shqiptarë, madje edhe ndaj atyre që rrinin cuc para Rugovës duke i eliminuar nga partia një nga një. Dhe mirë ua bënë! Realisht në këtë situatë më së vështiri e kishte Shqiptar Demaçi që ishte i kurthuar midis Protokollit të Shtetit dhe kërkesës së shokëve për organizimin e të pames për Bacën. Është interesant që pasi përfundoi e pamja, doli një publikim pamflet ku meritat për organizimin e të pames iu mveshën mashtruesve dhe spekulantëve që jo që nuk kishin kontribuar asgjë por as që kishin ndejtur në pamen për Bacën. Horra!

"Mëkatet " e Adem Demaçit ndaj shqiptarëve dhe kosovarëve dhe përgjigja e tyre ndaj këtyre "mëkateve ": Adem Demaçi kishte bërë shumë mëkate ndaj shqiptarëve që i shërbyen qençe Jugosllavisë dhe Serbisë duke ua prishur kumbarinë me ta, duke ua minuar vëllazërim – bashkimin, socializmin vetqeverisës, rehatinë personale dhe familjare duke kërkuar liri dhe çlirim për shqiptarët si dhe bashkim kombëtar. Këta e donin edhe Jugosllavinë si dhe Serbinë, babë e kishin Rankoviqin dhe Titon dhe, pas vdekjes së tyre e bënë babë Sllobodan Millosheviqin. Adem Demaçi kishte faje sepse gjatë tërë jetës, deri sa kaloi në amshim, çdo sekond ishte në gjendje të vdesë për idealin që e kishte dhe të cilin e kishte trashëguar nga patriotët shqiptarë që kurrë nuk e ndalën luftën për liri, çlirim dhe bashkim kombëtar. Përkundër kësaj, ai më së shumti u sulmua dhe u pushkatua nga vet shqiptarët , ata me të kaluar politike dhe kombëtare jugosllave në me krye Veton Surroin, sidomos gjatë Konferencës në Rambuje si dhe nga "paqësorët " e Himë Govës, të konvertuar nga Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës së Jugosllavisë në LDK-ë. Adem Demaçi u sulmua pse e përkrahu Albin Kurtin, deri në kohën kur i ndanë rrugët.

Adem Demaçi u sulmua edhe nga një pjesë e krahut të luftës kur nuk pajtohej me veprimet që i bënin. Për këtë arsye dha dorëheqje të menjëhershme nga Përfaqësuesi Politik i UÇK-së si dhe nga kryetari i bordit të RTK-së. Për çështje kombëtare dhe politike Baca Adem nuk bënte kompromis. U akuzua se e pengoi dhe e vonoi nënshkrimin e Marrëveshje së Rambujesë dhe kishte plotësisht të drejtë ; në takim me Robin Kuk në Shkup ( ishte edhe Albin Kurti, si përkthyes ) u përballë me një propozim 12 pikës, 8 prej të cilave ishin të panegociueshme kurse e para ishte se garantohej integriteti territoral dhe sovereniteti i Jugosllavisë/ Serbisë! Nuk ishte fati ynë që e nënshkruam Rambujenë por ishte fati që nuk e nënshkroi Serbia. Po ta nënshkruante sot Kosova do të ishte nën Serbi me të drejta të autonomisë kulturore. E akuzuan për projektin e Ballkanisë ndërsa sot Kosova e ka pozitën më të dobët se që do ta kishte me Ballkani. E akuzuan se është kundër Rugovës e që nuk ishte e vërtetë për faktin se Baca Adem ishte përkrahësi i madh i Rugovës, që nga Llogori i Përqëndrimit në Stara Gradishkë deri në çastin kur u vërtetua se Rugova, jo që nuk donte të merrte përgjegjësi të dilte në ballë të luftës së armatosur por edhe nënshtrimin ndaj Serbisë e kishte të padinjitetshëm. Rugova e donte lirinë por nuk ishte në gjendje ta bënte as sakrificën më të vogël për këtë liri. Adem Demaçi ishte e kundërta, për liri sakrifikonte çdo gjë ndërsa dorëzimin nuk e pranonte as si shprehje gramatikore. Baca , pas daljes nga burgu nuk pranoi të formonte parti politike që do ta rivalizonte Rugovën , përkundrazi na këshilloi ta përkrahim dhe të votojmë për Rugovën në zgjedhjet e para. Pas Dejtonit Rugovës i kaloi afati i përdorimit politik , ishte frenues dhe disfatist , sidomos kur në skenë doli Ushtria e Lavdishme Çlirimtare e Kosovës. Po të pranonte rolin udhëheqës në këtë luftë, Rugova do të përkrahej nga të gjithë dhe jam i sigurt se edhe lufta do të kishte tjetër përfundim , shumë më të favorshëm për ne. Rugova, si shumica e intelektualëve kishte sjellje oportuniste dhe mungesë guximi për rezistencë aktive. Rugova ishte i rrethuar me bashkëpunëtorë me proveniencë jugosllave, bindje dhe mendësi jugosllave, ish titistë të thekur që i kishin shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë andaj edhe mungonte gatishmëria për sakrificë në rrugën drejtë lirisë. Rugova ka dashtë që Baca Adem të qëndron në KMDLNj –ë apo në Lidhje të Shkrimtarëve por të mos futej në politikë, terren ky të cilin Rugova e kishte monopolizuar me mosveprim, mungesë guximi dhe nënshtrim.

E shumica e popullit e donin pikërisht këtë, rehati personale dhe familjare të cilën ua predikonte Rugova andaj nuk ishte e rastit numri aq i vogël i atyre që luftuan dhe e përkrahën luftën. Baca Adem ishte me bindje, qëndrim dhe veprim shumë para këtyre që kinse merreshin me politikë andaj nuk përkrahej, as nga vendorët, hiç këtu shokët e idealit dhe të sakrificës e as nga ndërkombëtarët për faktin se e dinin që me të nuk behej aksham

pazari e as ndonjë pazar tjetër që do të dëmtonin interesat kombëtare, politike dhe shtetërore. Për këtë arsye ia mbyllën të gjitha rrugët e angazhimit në ndonjë post të rëndësishëm politik, madje as deputet nuk e lejuan të bëhet . Madje nuk ia mundësuan asnjëherë që t'i drejtohej deputetëve dhe qytetarëve të Kosovës nga foltorja e Kuvendit në kohën kur nuk mbeti kush pa folë në këtë foltore. Madje edhe për persona të papërfillshëm të skenës ndërkombëtare mbeheshin seanca solemne dhe të jashtëzakonshme. Nga kompleksi i inferiotetit , pa asnjë dyshim. Vet fakti se midis propozimit që presidentë të bëhen Adem Demaçi apo Behgjet Pacolli , deputetët e Kuvendit të Kosovës , si përfaqësues të Popullit vendosën për Pacollin , në mënyrën më të trishtë dhe më të lakuriquar të mundshme e shpërfaqë mungesën e atdhedashurisë si dhe mungesën e respektit dhe vlerësimit për ate që çdo gjë që e pati e dha për popullin. Ky votim ishte prekja e fundit moral të një pusi që patëm menduar se ka ujin si biluri ndërsa ishte pikërisht e kundërta!

A ishte Baca Adem ashtu siç po e paraqesin disa "biografë" dhe "bashkëveprimtarë: Baca Adem Demaçi përkujtohet kryesisht në dy data; data e lindjes dhe data e vdekjes. Nga politikanët, mashtruesit, shokët e sinqertë, familjarët dhe të tjerët. Kur politikanët bëjnë homazhe, i thërrasin të gjitha mediat. Madje, pasi u nda nga LDK –ja, edhe presidentja e Albin Kurtit, Vojsa Osmani , kalimthi ndalej te varri i Bacës Adem, bashkë me presidentin real, Albin Kurtin. Ndërsa Presidenti, kryetari i kuvendit dhe kryeministri i vërtetë, Veton Surroi nuk ka qenë asnjëherë dhe nuk e përkujton. Këtë vit as Vojsa Osmani nuk ishte aty, në mos ka qenë në Kiev duke bërë plane ushtarake për kundërofensivën e Ukrainës kundër Rusisë dhe Putinit. Nuk kishte asnjë postim nga ajo, mbase ka qenë shumë e zënë në Ukrainë. Edhe kësaj radhe, një grup i shokëve të sinqertë të Bacës Adem vendosëm një buqetë me lule në varrin që paraprakisht e kishte pastruar Arbërie Demaçi ndërsa mjedisin e kishte pastruar Bekim Makolli. Ishte një mjedis më i këndshëm, jo në bazë të kujdesit institucional por në bazë të kujdesit të Arbëries dhe Bekimit. Ishim një grup prej 6 vetësh; Elmi Reçica, Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti, Dr. Haki Gashi, Bekim Makolli që e përfaqësonte edhe patriotin e madh shqiptar dhe të pandashmin, kryesisht në rreziqe me Bacën Adem, Shashivar Makollin, edhe ai në përjetësi.

Isha edhe unë. Të njëjtën ditë në studiot televizive dhe me postime u lajmëruan shumë individë të cilësuar si biografë të Bacës (Baca Adem nuk e kishte asnjë biograf) dhe bashkëveprimtarë, me të cilët Baca, për së gjalli as që komunikonte apo komunikonte prej zori kur nuk mund t'i përzënte nga shtëpia. Gjatë Rambujesë Bacën Adem e tradhtuan thuaja të gjithë bashkëpunëtorët përjashtuar Skender Kastratin, Albin dhe Zaim Kurtin, Milot Cakajn, Fexhrije Shalën, Bajrush Behrami, Shashivar Makolli dhe Behxhet Shalën, disa duke prerë biletën për Rambuje, të tjerët duke e kundërshtuar Bacën. Këta që i përmenda me emër dhe mbiemër ishin shokët e vërtetë të Bacës si dhe bashkëpunëtorë që i qëndruan besnikë edhe duke dhënë dorëheqje. Që nga viti 1990 e deri në fillim të luftës për të gjitha shpenzimet e Bacës në Kosovë por edhe të disa ish – të burgosurve politikë i mbuloni 100 %, Nuhi Ahmeti dhe Avdullah Dërguti ndërsa për shpenzime ku kërkoheshin shifra më të larta ishin Hetem Ramadani dhe Fatmir Zymberi. Shtëpitë ku Baca ndjehej i sigurt dhe ku shkonte kur të donte dhe në çdo kohë ishin të Shashivar Makollit, Ahmet Haxhisë (deri sa ishte gjallë), Rexhep Uka, Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti dhe te Behxhet Shala. Te unë ka qëndruar më së shumti. Kur dilnim jashtë Prishtine dhe mblidheshin shokët përgjegjësinë e merrnin, Elmi Reçica për Ferizaj dhe Kaçanik, Tahir Hani për Strugë dhe Maqedoni, Haki Gashi, Bali Gashi, Besim Baraliu me vëllezër dhe të tjerë për Therandë dhe Prizren.

Për Drenicë ishte Idriz Hysenaj kurse për Prishtinë dhe Llap ishim unë dhe familja Shala, Nuhiu me Dulin ndërsa shokë të qejfit dhe sefasë ishin që nuk i ekspozoheshin asnjë rreziku ishin Moamer Gjinolli, Dr. Gazi (Xhelal Pakashtica ) dhe i ndjeri Tahir Demaj në Pejë. Kjo ishte bërthama e shokëve të Bacës ku bën pjesë edhe Basri Ibrahimi, Zaim Beqiri në Tetovë, Asllan Reshiti në Tetovë dhe Bejtullah Ademi në Reçicë (Tetovë ). Të gjallët e këtij grupi i kanë ndejtur Bacës shumë afër deri në ditën kur kaloi në amshim. Edhe tani e përkujtojmë shpesh, me vizita, shkrime dhe takime të ndryshme. Edhe tani mbajmë kontakte me pasardhësit e Bacës Adem ku, Shqiptari është shumë i kujdesshëm ndaj shokëve të Bacës, si në prononcime për media, gjatë takimeve, përvjetorëve si dhe gëzimeve dhe hidhërimeve familjare. Përralla është se Baca ka jetuar me 90 euro, shokët nuk e kanë lënë keq për asgjë. Por Bacës nuk i kanë qëndruar paratë në xhep, vetëm ka kërkuar nëse një shok ka nevojë për to apo nëse dikush, qoftë edhe i panjohur ka kërkuar ndihmë, asnjëherë nuk është kthyer duarthatë. Bacës shokët i kanë dhënë shumë më shumë para se 1 000 euro të Hashim Thaçit. Baca, si institucion moral, politik dhe kombëtar ka pasur nevojë për kujdes institucionalë, paraja ka qenë nevoja e fundit, nëse edhe ka qenë farë. Baca e ka djalin Shqiptarin që është përkujdesur tërë kohën për të ndërsa Arbërie Demaçi ka qenë e jashtëzakonshme. Në aspektin shëndetësor për Bacën është përkujdesur jashtëzakonisht Prof . dr. Nexhmedin Shala prandaj për të kam një respekt të veçantë! Krijues i Albin Kurtit ishte Adem Demaçi, i kam ndihmuar pak edhe unë. Marrëdhëniet u plasën kur Albini deshi të ngritët mbi Krijuesin (Bacën Adem Demaçi) duke e përkrahur dhe respektuar vetëm verbalisht ndërsa e kundërshtonte dhe e mohonte praktikisht. Albin Kurti i Zyrës së UÇK-ës, sipas bindjes sime ishte patriot, trim, i vendosur dhe i gatshëm për çdo sakrificë. Për atë periudhë nuk ndërroj qëndrim sepse edhe vet isha pjesë e asaj Zyre. Albin Kurti sot është 100 përqind e kundërta e Albinit të kohës së Zyrës së UÇK-së, prandaj i ndamë rrugët me te, së pari Baca ndërsa, me një vonesë disamuajshe edhe unë (nuk e dëgjova me kohë këshillën e Bacës, çfarë budallai isha). U përmendën disa shqiptarë (të gjithë intelektualë shqiptarë dhe projugosllavë) që dëshmuan kundër Bacës . Unë di shumë më shumë emra. Dikush i arsyetoi se ishin dëshmitarë por nuk ishin spiunë. E vërteta është se ishin spiunë të gjithë këta dhe se kishin emra të koduar). Kanë dëshmuar jo vetëm kundër Bacës por kanë denoncuar edhe shumë patriotë të tjerë . Baca asnjëherë nuk ka bashkëpunuar me Zekrija Canën, nuk e ka vlerësuar aspak, përkundrazi . Para dy muajve një pinjollë i familjes udbashe Sllamniku doli publikisht me pohimin se Baca Adem asnjë ditë të vetme nuk ka qëndruar në burg dhe se ka qenë bashkëpunëtor i UDB-së. Askush nuk reagoi; as KM-ja, as krye parlamentari, as "biografët", as "bashkëveprimtarët ", askush hiç. Ndërsa kur emri i Adem Demaçit iu duhet për konsum politik, pa asnjë skrupull e keqpërdorin, nga KM-ja, kryeparlamentari , "biografët " dhe "bashkëveprimtarët ". Adem Demaçi është sulmuar për së gjalli, po sulmohet edhe tash kur ka kaluar në përjetësi.

Koha e Adem Demaçit pashmangshëm do të vjen kur horrat dhe shpërdoruesit e ndjenjave politike dhe kombëtare të zhveshën në tërë paturpësinë dhe pafytyrësinë e tyre. Ajo kohë sa ka filluar. Shqiptar Demaçit nuk i takon ta mbrojë babin e vet shkaku se aktiviteti dhe jeta e Bacës Adem thuaja e ka lënë Shqiptarin pa e shijuar plotë ndjenjën e të pranisë fizike dhe dashurisë prindërore të babait. Pastaj, nëse thuhet se Baca Adem, e pa asnjë dyshim edhe është vlerë morale, kombëtare, politike dhe shtetërore e të gjithë shqiptarëve, institucioneve iu takon ta mbrojnë emrin dhe veprën e papërsëritshme dhe të paarritshme, sot dhe sa të ekzistojë populli shqiptar, emrin e Adem Demaçit, Frymëzuesit dhe Kuptimit të Luftës për Liri, Çlirim, Pavarësi dhe Bashkim Kombëtar.

Deri në atë kohë, mashtruesit, antikombëtarët dhe dhunuesit e shqiptarëve, bijë dhe bija të kriminelëve (vrasësve) ordinerë (si analistë të pushteti) do të deklarohen si bashkëmendimtarë dhe bashkëveprimtarë të Adem Demaçit. Vetëm te shqiptarët ndodhë kjo çmenduri; personaliteti më i merituar për të gjitha që i kemi sot dhe që duhet t'i bëjmë në të ardhmen, në të njëjtën kohë është personi më i sulmuar, si për së gjalli ashtu edhe tani kur ka kaluar në përjetësi! Ne, shokët e sinqertë të Bacës Adem Demaçi ishim me fat që jetuam në kohën e tij, jemi të pikëlluar që nuk është në mesin tonë por, në të njëjtën kohë, jetën dhe ëndrrat mundohemi t'i përshtatemi me mësimet e këtij Grupi moral, kombëtar, politik, shpirtëror dhe shtetëror.

**28 korrik 2023, Prishtinë**






# Sport


Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Shorti për edicionin e ri të Superligës, mësohen çiftet e javës së parë



**Prishtinë, 28 korrik** - Në praninë e Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve është bërë tërheqja e shortit për edicionin e ri të garave 2023/2024 për Superligë. Fillimisht kryetari i KG-së, Abdyl Bellopoja i njoftoi përfaqësuesit e klubeve me procesin e tërheqjes së shortit dhe me hartimin e akteve të reja normative për këtë edicion, si dhe rreth përgatitjeve për fillimin e Ligës U21 dhe formatin e saj, për të cilën do të vlejë kalendari i njëjtë i garave të Superligës, por që do të zhvillohet me 27 xhiro dhe më pas me gara të "play-off"-it. Ndërkohë, pas tërheqjes së shortit për javën e parë të Superligës që nis më 12 gusht do të ballafaqohen: Liria - Ballkani, Drita - Llapi, Dukagjini - Malisheva, Fushë Kosova - Gjilani, Prishtina - Feronikeli.

# Ministri Çeku: Kosova kandidate serioze për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030

EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**



**Prishtinë, 28 korrik** - Shteti i Kosovës është kandidat serioz për organizmin e Lojërave Mesdhetare 2030. Kështu ka bërë të ditur ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku. Kosova synon organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030 dhe një gjë e tillë pritet të ndodh pasi tashmë kanë filluar vizitat e para nga Komisioni vlerësues i Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare. Ky komision kryesohej nga presidenti Julian Pace Bonello dhe sekretari i përgjithshëm i ICMG-së, Iakovos Filippousis. Ata pritet të bëjnë vlerësim të gjendjes dhe zhvillojnë takime me zyrtarë të nivelit të lartë institucionalë për ta konfirmuar mbështetjen e tyre për organizim. "Kosova kandidate serioze për organizimin e Lojërave Mesdhetare 2030. Po punojmë me përkushtim të plotë që në vendin tonë të organizojmë një prej ngjarjeve më të mëdha sportive në botë. Programi i Lojërave Mesdhetare përmban 24 sporte dhe pjesëmarrje të afër 5 000 sportistëve. Tashmë jemi një hap para. Sot në vendin tonë filluan vizitën Komisioni vlerësues i Komitetit Ndërkombëtar të Lojërave Mesdhetare, kryesuar nga presidenti Julian Pace Bonello, dhe të përcjell nga sekretari i përgjithshëm i ICMG-së, Iakovos Filippousis. Ata pritet të bëjnë vlerësim të gjendjes dhe zhvillojnë takime me zyrtarë të nivelit të lartë institucionalë për ta konfirmuar mbështetjen e tyre për organizim", ka thënë ministri Çeku. Çka përfiton Kosova me organizimin e Lojërave Mesdhetare, ministri ka treguar në detaje: "Konsolidim të imazhit shtetëror në arenën ndërkombëtare, përforcim të përkatësisë dhe identitetit shtetëror, infrastrukturë fizike të modernizuar, ekonomi të ringjallur përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe zhvillimit të turizimit sportiv, fuqizim të rezultateve sportive dhe zhvillim të qëndrueshëm të sportit në vend".

# Krasniqi: Shihemi shpejt shqipe




**Prishtinë, 28 korrik** - Haxhi Robin Krasniqi është duke u bërë gati për atë që e ka konsideruar si meçin më special në karrierën e tij. Boksieri kosovar do t'i kryqëzojë dorëzat me kundërshtarin Nadjib Mohammedi në meçin e vlefshëm për versionin WBC. Boksieri me nënshtetësi gjermane, por gjithmonë me Kosovën në zemër, i ka ftuar tifozët të jenë prezent në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë më 5 gusht. Ky meç do të jetë jetik për tifozët shqiptarë, të cilët do ta kenë rastin dhe mundësinë ta shohin ish-kampionin e botës në boksin profesionist të boksojë për herë të parë në tokën shqiptare. "Asnjëherë më gati, për të ofruar e përjetuar emocionet e papërballuara ndonjëherë, në vendin tim e para njerëzve të zemrës. Shihemi shpejt shqipe, më 5 gusht, në stadiumin "Fadil Vokrri", në Prishtinë", ka shkruar në "Facebook" kampioni i parë dhe i vetëm shqiptar i botës në boks.



## Vashat e Kosovës munden nga Holanda

**Prishtinë, 28 korrik** - Kosova U20 ka pësuar humbje nga Holanda me rezultat 87:57 (23:17, 23:12, 22:12, 19:16), në Kampionatin Evropian, Divizioni B, që sot nisi në Rumani. Vashat e Kosovës rezistuan në periudhën e parë, që përfundoi 23:17, por në periodën e dytë dhe të tretë holandezët ishin më të mira, ndërsa rezultati pas 30 minutash ishte 78:41. Te Kosova u dallua Astera Tuhina me 22 pikë e pesë kërcime, 11 pikë shënoi Anila Selmani dhe dhjetë Enisa Kamerolli.

Kosova ndeshjen e ardhshme e ka ndaj Kroacisë, të dielën nga ora 12:00, ndërsa më pas do të ndeshen me Slloveninë, në ndeshjen e fundit në grupe.

## Italia bashkë me Turqinë shpallin kandidaturën për Evropianin 2032

ROMË, 28 KORRIK - Agjencia italiane e lajmeve ANSA ka konfirmuar se Federata Italiane e Futbollit dhe ajo turke, i kanë dërguar një letër zyrtare në UEFA, ku hedhin kandidaturën e përbashkët për të organizuar Evropianin e vitit 2032. Italia dhe Turqia ishte kandidatet e vetme në garë për të organizuar këtë event, por së fundi dy Federatat kanë rënë dakord për të organizuar së bashku atë. Kështu, duke mos pasur asnjë kandidaturë tjetër, pritet që UEFA të konfirmojnë zhvillimin e Evropianit 2032 në këto dy shtete. Vendimi për të dalë me një kandidaturë të përbashkët erdhi pas një takimi që është zhvilluar në Romë mes presidentit të Federatës Italiane të Futbollit, Gabriele Gravina dhe atij Turk, Mehmet Buyukeksi. UEFA do të marrë vendimin për shtetin apo kandidaturën fituese më 10 tetor të këtij viti, gjatë një mbledhje të komitetit ekzekutiv, në Nyon (Zvicër). Europiani i vitit 2024 do të zhvillohet në Gjermani, por ende nuk dihet vendi organizator i Euro 2028.

# Katër trajnerë potencialë të Kosovës në Turqi

PRISHTINË, 28 KORRIK - Katër trajnerë potencialë nga Kosova prej 27 deri më 31 Korrik 2023 do të qëndrojnë në Stamboll të Turqisë. Vizita e trajnerëve potencial kosovarë, Nderim Januzaj, Arta Mustafa, Butrint Bajraktari dhe Arsim Berisha, do të bëhet në kuadër të projektit të Fondit për Zhvillim të Gjeneratave të Reja (YDF) në FIBA Europe në të cilin marrin pjesë shtetet si Kosova, Turqia, Bullgaria Maqedonia Veriore dhe Rumania. Kjo është edhe një mbështetje nga Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) për trajnerët vendorë, edukimin dhe zhvillimin e tyre. Trajnerët kosovarë, së bashku me ata bullgarë, rumunë dhe maqedonas do të kenë mundësi që për gjashtë ditë, sa do të qëndrojnë në Stamboll të vizitojnë klubet më të mëdha turke, por edhe të marrin pjesë në seancat e tyre stërvitore, në mënyrë që të përfitojnë sa më shumë njohuri bazike rreth basketbollit. Po ashtu këta trajnerë do të kenë mundësinë që ta përcjellin seminarin e basketbollit që do të mbahet më 29-30 korrik. Qëllimi i këtij projekti të FIBA Europe është shkëmbimi i përvojave të shteteve pjesëmarrëse, bashkëveprimi kulturor, ndërtimi i marrëdhënieve dhe fuqizimi i raporteve ndërmjet partnerëve.




# Leclerc: Maksimumi është vend i dytë për konstruktorë

BRUKSEL, 28 KORRIK - Piloti monogask i Ferrari, Charles Leclerc, në prag të garës së Belgjikës që zhvillohet këtë fundjavë në pistën legjendare të SPA, ka folur për pjesën e mbetur të sezonit. Ai mbetet optimist dhe shpreson se pushimet verore do të sjellin në pistë një makinë ndryshe nga kjo e deritanishmja. "Unë përpiqem gjithnjë të jap më të mirën. Kjo është pistë e veçantë për mua, pasi këtu kam arritur fitoren e parë. Kjo është një garë me të papritura dhe me shumë gjasa do të kemi mot me shi. Shpresoj që kjo gjë të na ndihmojë këtë herë", ka thënë Leclerc. "Nëse e gjithë pista do të jetë e lagur mund të na ecë mbarë, nëse do të jetë gjysmë për gjysmë do të kemi sërish vështirësi. Shpresoj që provat dhe gara të mos kenë shumë diferenca, siç ndodhi në Hungari. Gjithsesi, duhet shumë punë dhe presim që këtu të dalim më mirë", ka shtuar monogasku. "Ne kemi pasur disa progrese, por me sa duket nuk janë të mjaftueshme. Ne u jemi afruar makinave të tjera por jo Red Bull. Ne kemi biseduar dhe programojmë të jemi më lart pjesën e mbetur të sezonit. Jemi të vetëdijshëm se nuk shkojmë dot më shumë se vend i dytë për konstruktorë", ka deklaruar Leclerc.



## SHKURT

### Statuja e Wengerit arrin në 'Emirates'

Gazetari londinez Chris Wheatley ka publikuar foto të statujës së Arsene Wenger, e cila tanimë ka arritur te Arsenali. Gjatë ditëve në vazhdim Arsenali pritet që ta zbulojë statujën e Wengerit te stadiumi "Emirates", në shenjë nderimi për ish-trajnerin francez. Më herët këtë muaj, u bë e ditur se Wengerit do t'i bëhet një statujë te stadiumi i ish-klubit të tij, dhe si duket francezi nuk do të pres shumë për zbulimin e saj.

### PSG-ja: Mbappe kushton 250 milionë euro

Real Madridi tani e di çmimin e kërkuar nëse dëshiron të sjellë Kylian Mbappe në "Santiago Bernabeu" këtë verë. Paris Saint-Germain thuhet se pranoi një ofertë prej 300 milionë euro nga Arabia Saudite për Mbappen nga Al Hilal, i cili do t'i kishte dhënë atij një marrëveshje njëvjeçare me të ardhura të mundshme që arrijnë në 700 milionë euro. Por, pasi sulmuesi francez e refuzoi idenë, PSG është detyruar të kërkojë diku tjetër për një blerës të mundshëm të Mbappes. Nuk ka dyshim se blerësi në fjalë është Real Madridi dhe PSG-ja ka vendosur një çmim për yllin e tyre 24-vjeçar. Sipas gazetës "Marca", klubi nga "Parc des Prince" kërkon 250 milionë euro për 'kokën' e Mbappe nëse "Los Blancos" duan të bëjnë një lëvizje. Mediumi spanjoll shton se nëna dhe agjenti i tij, si dhe një përfaqësues tjetër, Kia Joorabchian, po përpiqen të negociojnë atë çmim për ta bërë një lëvizje më të arritshme për "Los Blancos".

### Klubi i Ronaldos ofron 37 milionë euro për Manen

Al Nassr pritet ta bëjë ofertën e parë për ta transferuar Sadio Manen. Klubi nga Arabia Saudite është optimist se do ta arrijë marrëveshjen me Bayern Munichun për ta blerë sulmuesin senegalez për 37 milionë euro, mëson eksperti i transfereve, Fabrizio Romano. Ndërkohë, klubi i Saudi Pro League po diskuton edhe me ish-futbollistin e Liverpoolit. Gjiganti bavarez po planifikon ta shesë lojtarin që i solli probleme në edicioin e kaluar pasi e grushtoi bashkëlojtarin e tij, Leroy Sane. Mane pritet të bëhet bashkëlojtar me Cristiano Ronaldon në ligën elitare të futbollit në Arabinë Saudite, e cila është duke i mbledhur yjet e futbollit evropian.

### Mahrezi transferohet te Al Ahli

Sulmuesi anësor algjerian, Riyad Mahrez, ka përfunduar zyrtarisht transferimin e tij nga Manchester City te klubi saudit i Al Hilal. 32-vjeçari, pas një karriere të suksesshme në Premier League me Leicester dhe Manchester City, tashmë do të vazhdojë aventurën e tij futbollistike në Arabinë Saudite, aty ku do të gjejë shumë kolegë të tijtë nga Evropa. Në 236 ndeshje me City, Mahrez ka shënuar 78 gola, ka asistuar 59 herë dhe ka fituar 11 trofe. City përfitoi 30 milionë paund nga shitja e tij dhe Mahrezi do të ketë një kontratë deri në qershor 2027.

## Drejtuesit e Bayernit në Londër për Kanen

Kjo fundjavë do të jetë vendimtare për të ardhmen e Harry Kane. Sulmuesi anglez dëshiron të largohet nga Tottenhami dhe Bayern Munich po bën gjithçka për ta marrë në Gjermani. Sipas informacioneve të raportuara nga gazeta "Bild", presidenti Jan-Christian Dreesen dhe kreu i skautingut Marco Neppe kanë udhëtuar sërish në Londër për të takuar Daniel Levy, shefin e klubit të Tottenham, duke tentuar kështu të gjejnë një marrëveshje për transferimin e kapitenit të kombëtares angleze. Në fund të qershorit, "Spurs" refuzuan ofertën fillestare prej rreth 70 milionë euro, plus bonuse. Kane e ka qetësuar Bayern disa herë, duke përsëritur gatishmërinë e tij për të lëvizur, pasi ka luajtur më shumë se 400 ndeshje për Tottenham dhe nuk ka fituar asgjë në rang klubesh. Me skadimin e kontratës së tij pas një viti, sulmuesi është i vendosur të përballet me një fazë të re në karrierë. Shtypi gjerman raporton gjithashtu se gruaja e tij, Katie Goodland, ishte në Mynih ditët e fundit për blerjen e mundshme të një shtëpie të ardhshme. Mësohet se Bayern ka rritur ofertën deri në 90 milionë euro plus bonuse.

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare
Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company

TREPÇA

Duke u bazuar ne Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 28.07.2023 bënë shpallje publike:

## NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-09

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirave
Depoja e prodhimit - Industria Kimike

Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë

Numri i ofertave të pranuara: 1 (një)

## ME KONTRATË SHPËRBLEHET

Loti 1 Çmimi 509.76 €/Muaj/Me TVSH – INNO Recycling

Kontrata është paraparë të nënshkruhet me datën 02.08.2023 ora 10:00

**AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)**

| | | |
|---|---|---|
| **Emri zyrtarë**: *Trepça sh.a.* | | |
| **Adresa postare**: *Parku inustrial* | | |
| Qyteti: *Mitrovicë* | Kodi postarë: *40000* | Shteti: *Kosovë* |
| **Kontakti**: *Burim HAJDINI* | | Telefoni: *+383 (0) 28 538 050* |
| Email: *hajdini_b@hotmail.com* | | Faksi: *+383 (0) 28 539 202* |
| *www.trepcacorporation.com* | | |

*Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 te Rregulloren për dhënie me qira te pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokolli 119 date 11.01.2021.*












## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Albert Dina shpall të pavlefshme dëftesat e kl I – IX - SHFMU "Faik Konica" Celinë.

- Besmir Hasani shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI –IX- SHFMU "Mati Logoreci" Prizren.

- Durim Lubiceva shpall të pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L